



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE –PEJË
OSNOVNI SUD PEC – BASIC COURT OF PEJA

SHPALLJA E REKRUTIMIT PËR SHËRBYES JO – CIVIL

Në mbështetje të nenit 8 Ligji Nr.03/L-212 i Punës, nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.05/2014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Qarkore Administrative Nr. 01/2014 të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike me datë 8 dhjetor 2014 dhe Vendimin (KGJK, nr. 10/2016) Për Kategorizimin e Pozitave të Nëpunësve Civil të Administratës Gjyqësore në Shërbyes Jo-Civil .

Gjykata Themelore në Pejë

shpall:

K O N K U R S : Nr. 2/ 2017

1. Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog Roje Sigurimi 1 pozitë.

Pozita nr.1

Titulli i vendit të punës: Roje Sigurimi

Numri i pozitave : 1 (një) pozitë

Koeficienti: 5

Institucioni: Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog

Lloji i vendit të punës: Pa afat të caktuar, me orar të plotë.

Nëpunësi mbikëqyrës : Udhëheqësi i Zyrës për Shërbime të Përbashkëta

Qëllimi i vendit të punës: bënë sigurimin fizik të objektit, personelit dhe publikut brenda dhe për brenda perimetrit të objektit të gjykatës për 24 orë pa ndërprerje. Kryen kontrollimin e personave të cilët dëshirojnë të kenë qasje në objektin e gjykatës. Mban rregullin dhe qetësinë dhe orienton palët brenda ambienteve të gjykatës.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Sigurimi fizik i objektit, personelit dhe publikut brenda perimetrit të gjykatës.
- Monitorimi i sistemit të kamerave që janë të vendosura në objektin e gjykatës dhe përcjellë lëvizjet e personelit dhe të palëve në gjykatë.
- Patrullimet e herë pas herë me qëllim të sigurimit fizik sa më efikas të objektit dhe personelit në gjykatë
- Përpilon raporte me shkrim mbi pranim – dorëzimin e detyrës si dhe përpilon raport mbi incidentin e mundshëm
- Kryen detyra tjera në çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e stafit dhe objekteve të gjykatave dhe me kërkesën e mbikëqyrësit kryen edhe punë të tjera.

Njohuri, Shkathtësi dhe aftësi për vendin e punës:

- Shkathtësitë e dëshmuara të menduarit strategjik, zbatimi i detyrave të sigurimit
- Shkathtësitë e dëshmuara për komunikim me shkrim dhe me gojë
- Preferohet të ka njohuri për komunikim në gjuhën e minoriteteve.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimet:

- Diplomë e shkollës së mesme .

Përvoja e punës:

- Së paku 1 vite përvojë pune profesionale në lëmin e sigurimit ose të ngjashme .
-

VEREJTJE:

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në Web portal, si dhe në njërin nga gazetat ditore „ Zëri „, duke filluar nga data e publikimit më **12/06/2017** gjer më datën **26/06/2017** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin Nr.03/L-212 të Punës dhe të drejtat dhe detyrimet e të punësuarit që themelojnë marrëdhënie pune sipas këtij konkursi do të rregullohen në pajtim me Ligjin Nr.03/L-212 të Punës.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit si në vijim:

1. Dëshmitë mbi kualifikimet shkollore
2. Dëshmitë mbi përvojën e punës
3. Dokumentin e identifikimit (përfshirë dhe çertifikatën e lindjes)
4. Çertifikimet e ndryshme
5. Çertifikata që nuk jeni nën hetime dhe
6. Çdo dokument tjetër të kërkuar sipas konkursit apo që ju mendoni se është relevant për konkurimin tuaj

Aplikimi: Kërkesa ([Aplikacioni](#)) për punësim gjendet në Web portal: <http://www.gjyqesori-rks.org/> ose mundë ti merrni në recepcionin e : Gjykatës Themelore në Pejë Rr. Mbretëresha Teutë p.n.

Dhe në Degën :

Gjykata Themelore Pejë, Dega në Istog Rr. “ Fadil Ferati” Nr.4. Istog.

Aplikacionet e plotësuar dorëzohen, personalisht apo përmes postës, në adresën: Aplikacionet e plotësuar mund ti dorëzoni në Gjykatën Themelore në Pejë, „ Rr. Mbretëresha Teutë „ pn si dhe përmes postës – Gjykata Themelore Pejë - kodo postar 30000 .

Dhe në Degën e Gjykatës Themelore Pejë:

Gjykata Themelore Pejë – Dega në Istog Rr. „ Fadil Fërkatii, Istog – kodi postar 31000

Aplikacionet e dorëzuara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditëve të punës nga dita e dorëzimit në postë.

Vetëm kandidatët të cilën i plotësojnë kriteret e konkursit do të selektohen për listën e ngushtë dhe do të ftohen në testin me shkrim, ata që kalojnë testin me shkrim do të thirren në intervistë me gojë. Kandidatët që ftohen në testimin me shkrim, janë të obliguar që me vete të sjellin dokumentin origjinal për verifikim para Komisionit.

Informimi i kandidatëve do të bëhet përmes telefonit, email adresës, ose përmes <http://www.gjyqesori-rks.org/> **Gjykata Themelore në Pejë.**

Njoftimet e tjera i gjeni në <http://www.gjyqesori-rks.org/> , ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: **039/433-355** (numri i telefonit të zyrës së pranimit të aplikacioneve për kandidatë), çdo ditë pune, prej orës **08:00 – 16:00**.
